



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:164415

Datë: 26.10.2021

Numri i dokumentit: 02327178

PKR.nr.102/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Shaqir Zika, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë e kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarve F. K., nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, të pandehurit R. K. dhe M. I. që të dy nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i pandehuri V. P. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale importi, eksporti, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve apo mjeteve plasëse nga neni 364 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm tani Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/Inr.76/2021, të datës 29.07.2021, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 19.10.2021, në prezencën e Prokurores së shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, të akuzuarve F. K., si dhe mbrojtësin e tij av. Urim Pozhegu, nga Gjakova, sipas autorizimit në lëndë, R. K., M. I. si dhe V. P. së bashku me mbrojtësen av. Feride Xani nga Gjakova, sipas autorizimit në lëndë, ku në të njëjtën datë shpalli këtë, ndërsa **me datën 26.10.2021** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuarit:

1.F. K., nga i ati Xh. e ëma ,L., e gjinisë M., data e lindjes . . . në Gjakovë, me banim ne fshatin . . . K Gjakovë, ka te kryer shkollën e mesme, i pa pune, i pa martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, me nr. personal . . ., shqiptar shtetas i R. së Kosovës.

2. R. K., nga i ati Xh., e ëma L. e gjinisë M., data e lindjes . . . në Gjakovë, me banim ne fshatin . . . K Gjakovë, , ka te kryer shkollën e mesme, student, i pa pune, i pa martuar, i gjendjes se dobët ekonomike, me nr. personal . . . , shqiptar shtetas i R. së Kosovës.

3. M. I., nga i ati M., e ëma Gj. e gjinisë K., data e lindjes . . . në Gjakovë, me banim ne fshatin . . . K Gjakovë, , ka te kryer shkollën e mesme, punëtorë, i martuar, I gjendjes se dobët ekonomike, me nr. personal . . ., shqiptar shtetas i R. së Kosovës.

4. V. P., nga i ati Xh., e ëma C. e gjinisë A., data e lindjes . . . në Gjakovë, me banim ne fshatin . . . K Gjakovë, ka te kryer shkollën e larte, punëtorë ndërtimtari, i martuar baba i një fëmije, me nr. personal . . ., shqiptar shtetas i R. së Kosovës.

JANË FAJTOR

I pandehuri V. P.:

I. Ne fillim te muajit qershor 2021 ne fshatin . . . K.Gjakove, ne kundërshtim me ligjin e zbatueshëm ne lidhje me armët, pa autorizim shet, armen e tipit Zoraki, model 917-B, prodhim turk, pa nr.serik ekalibrit 9mm, në atë mënyrë që fillimisht bjen ne kontakt me te pandehurin M. dhe atë përmes të pandehurit F. ,pastaj merren vesh rreth blerjes se armës e ku me pas ia sjelle këtë revole tek kafiteria “. . .” ne Gjakove dhe për te njëjtën revole si kompenzim merr 600 euro, e njëjta arme është gjetur ne posedim te pa autorizuar tek i pandehuri M. I..

Me çka ka kryer veprën penale importi, eksporti, furnizimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armeve apo materieve plasëse nga neni 364 par.1 te KPRK-se.

I pandehuri F. K.:

II.Me date 08.05.2021, rreth orës 02:24 min, ne fshatin . . . K. Gjakovë, e përdor armën ne kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që pa ndonjë arsye te caktuar gjuan dy-tri herë ne ajër me armën e tipit Revole Ekol Special, prodhim turk, me nr.serik EV-10-11-0989, kaliber 7.65mm, si dhe një karikatorë dhe një fishek i te njëjtit kalibër, e cila armë më pas i është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor.

-Me çka ka kryer veprën penale, përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

III. Nga data e pacaktuar e deri me dt.16.07.2021, ne fshatin . . . K Gjakovë, pa autorizim ka poseduar armë e municion në kundërshtim me nenin 4 prg.1 nën.prg.1.1 të ligjit për armë e R. Kosovës, dhe atë: 1 (një) Armë automatike e tipit Revole Ekol Special, prodhim turk, me nr.serik EV-10-11-0989, kaliber 7.65mm, si dhe një karikatorë dhe një fishek i te njëjtit kalibër e cila armë më pas i është sekuestruar.

- Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së.

I pandehuri R. K.:

IV. Nga data e pacaktuar e deri me dt.14.07.2021, rreth orës 06:30min, ne fshatin . . . K Gjakovë, pa autorizim ka mbajtur armë e municion në kundërshtim me nenin 4 prg.1 nën.prg.1.1 të ligjit për armë e R. Kosovës, ne atë mënyrë qe gjate bastisjes se bere me urdhëres te Gjykatës ne shtëpinë e te pandehurit R. i është gjetur ne posedim te pa autorizuar arma automatike AK-47, me numër serik 20064822, prodhim i panjohur, dhe dy karikatorë, një thike ushtarake, katër fishek te revoles, tre fishek te kalibrit 7.62 dhe një fishek i kalibrit 9mm, arma dhe municioni janë sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor.

Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së.

I pandehuri M. I.:

V. Me dt.15.07.2021, ne fshatin . . . K Gjakovë, pa autorizim ka mbajtur armë në kundërshtim me nenin 4 prg.1 nën.prg.1.1 të ligjit për armë e R. Kosovës, dhe atë: një revole e markës Zoraki, model 917-B, prodhim turk, pa nr.serik ekalibrit 9mm, një karikator dhe 6 fisheke te te njëjtit kalibër, ku pas kuptimit nga masat e fshehta të lëshuara për rastin e të pandehurit F. ,kuptohet se i pandehuri M. posedon arme ky i fundit pas thirrjes nga ana e zyrtareve policore e pranon se posedon armë dhe armen iu dorëzon zyrtareve policore.

- **Me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71 , 72 dhe nenit 364 par.1, 367 par.1, nenit 366 par.1, të KPRK-së, lidhur me nenin 365 dhe 366 te KPPK-se, të akuzuarit i :

G J Y K O N

1.Të akuzuarin V. P.; për dispozitivin I të akuzës, për veprën penale importi, eksperti, furnizimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitje e paautorizuar e armëve apo materialeve plasëse nga neni 364 par.1 të KPRK-së, i shqipton **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej pesëqind (500) Euro, si dhe **DENIMI Me BURGIMI**, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

Me kërkesën e mbrojtëses së të akuzuarit av. Feride Xani si dhe pëlqimin e të akuzuarit V. P., konform nenin 44 të KPRK-së, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej njëmijedyqindën(1.200) Euro.

Andaj gjykata konform nenit 76 par.1 dhe 2 nenpar.2.4 te KPRK-se, te akuzuarit i shqipton:

DENIM UNIK ME GJOBË në shumë prej njëmijeshtatëqind (1.700) Euro, të cilin dënim i akuzuari duhet të paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund te paguaj dënimin me gjobe, atëherë Gjykata te akuzuarit ja zëvendëson dënimin me gjobe në dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetëdhjetepesë (85) ditëve, duke llogaritur çdo dite te kaluar ne burgim nga njëzetë (20) Euro.

2.Të akuzuarin F. K. - për dispozitivin II te akuzës, për veprën penale : përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, **ME DËNIM ME KUSHT**, duke ia vërtetuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit te verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

- Për veprën penale si në dispozitivin III te akuzës, për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, **ME DENIM ME GJOBË** në shumë prej pesëqind (500) Euro, i cili dënim do të paguhet në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata të akuzuarit ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëzetepesë (25) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga njëzet (20) Euro.

3.Të akuzuarin R. K.-për dispozitivin IV të akuzës, për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, **ME DENIM ME GJOBË** në shumë prej tetëqind (800) Euro, i cili dënim do të paguhet në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata të akuzuarit ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim burgimi në kohëzgjatje prej dyzetë (40) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga njëzet (20) Euro.

4.Të akuzuarin M. I.- për dispozitivin V të akuzës, për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, **ME DENIM ME GJOBË** në shumë prej pesëqind (500) Euro, i cili dënim do të paguhet në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata të akuzuarit ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëzetepesë (25) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga njëzet (20) Euro.

Ndaj të akuzuarve konfiskohen: 1(një) arme automatike AK-47, me numër serik 20064822, prodhim i panjohur, së bashku me dy karikator, pa fishek, 1 (një) thike ushtarake dhe një shufër metalike, 3 (tre) fishek, kalibër 9mm, 1 (një) revole e markës Zoraki, mod.917-B, prodhim turk, pa numër serik, kalibër 9mm P.A.K, se bashku me një karikator dhe 6 (gjashte) fishek të të njëjtit kalibër, 1 (një) revole e markës EKOL Special, prodhim turk, me numër serik EV-10-11-0989, kalibër 7.65 mm, P.A.K se bashku me një karikator dhe një fishek të të njëjtit kalibër, të konfiskohen, si objekt i kryerjes së kësaj vepre penale.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, këto armë duhet të shkartohej nga policia e Kosovës, me bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Gjakovë, pasi që të vërtetohet se këto armë nuk janë përdorur në ndonjë krim tjetër.

Detyrohen të akuzuarit, që ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësorë secili veç e veç shumë me nga tridhjetë (30) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit, secili veç e veç shumë me nga pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP/Inr.76/2021 të datës 29.07.2021, kundër të akuzuarve F. K., nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, të pandehurit R. K. dhe M. I. që të dy nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i pandehuri V. P. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale importi, eksporti, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve apo mjeteve plasëse nga neni 364 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 19.10.2021, në të cilën kanë marr pjesë Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, F. K., së bashku me mbrojtësin av. Urim Pozhegu, nga Gjakova, i caktuar sipas autorizimit, R. K., M. I. j si dhe V. P. si dhe mbrojtësja e saj av. Feride Xani nga Gjakova, sipas autorizimit në lëndë.

Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve, andaj ka propozuar që të njëjtit të shpallën fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

I akuzuari F. K. gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet dhe shton se është e vërtetë që me këtë armë në shenjë të gëzimit ka shtënë disa herë në ajër, të njëjtën armë asnjëherë nuk e ka keqpërdorë, arma i është sekuestruar gjatë bastisjes së shtëpisë, dhe të njëjtën e kam dorëzuar vetë personalisht shprehi keqardhje, premtoj se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

I akuzuari R. K. gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe shton se arma automatike i është gjetur gjatë bastisjes së shtëpisë në ankesin e shtëpisë, e njëjta ka qenë pa municion, të njëjtën kur nuk e kam keqpërdorur, shprehi keqardhje, premtoj se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

I akuzuari M. I. gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe shton se është e vërtetë që arma, revolva i është konfiskuar me rastin e bastisjes së shtëpisë së tij, të njëjtën armë nuk e kam keqpërdorë asnjëherë dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

I akuzuari V. P. gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe shton se armën e tipit “zorake”, ia ka shitur këtu të pandehurit M., me ndërmjetësimin e të pandehurit F., pasi që i njëjti më ka pasur borxh, pendohem thellë për veprimet e mia që i kam ndërmarrë, dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj Hyseni, i dëgjova këtu të pandehurit të cilët veç e veç pranuan veprat penale për të cilat akuzohen po ashtu të njëjtit edhe gjatë procedurës hetimore secili ka pranuar fajësinë për këto vepra, ky pranim i fajësisë i bërë nga të akuzuarit ka mbështetje të plotë në provat që ndodhen në shkresa e lëndës, andaj mbi këtë bazë i propozoi gjykatës që të pranoi fajësinë e të akuzuarve.

Mbrojtësi i të pandehurit F. K. av. Urim Pozhegu duke dhënë mendim rreth pranimi të fajësisë deklaroi se: konsideroj se pranimi i fajësisë nga ana e të mbrojturit tim është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme duke i sqaruar që më parë favorët dhe pasojat ligjore të pranimi të fajësisë, në çdo fazë të procedurës penale. Shtoj se të njëjtit janë sqaruar mjaftueshëm me dispozitat ligjore të KPRK që kanë të bëjnë me veprat penale me të cilat inkriminohen dhe se të njëjtat i ka kuptuar andaj i propozoi gjykatës që të aprovoi pranimin e fajësisë si të sinqertë dhe esesi si beneficion që ofron ligji në mënyrë formale.

Mbrojtësi i të pandehurit V. P. av. Feride Xani duke dhënë mendim rreth pranimi të fajësisë deklaroi se: Pas konsultimeve të mjaftueshme dhe sqarimit të pasojave juridike lidhur me pranimin e fajësisë i mbrojturi imë me vetëdije të plotë dhe pa ndonjë ndikim të jashtëm deklaroi se e pranon fajësinë për veprën për të cilën akuzohet i njëjti veprën penale e ka kryer duke mos qenë i vetëdijshëm për pasojat juridike të kësaj vepre. Lus gjykatën që të e aprovoi pranimin e fajësisë ndërsa me rastin e matjes së dënimit për të mbrojturin tim pranimi i fajësisë të konsiderohet si rrethanë lehtësuese.

Pasi që këtu të pandehurit pranimin e fajësisë e kanë bërë në mënyrë të vullnetshme, pas shpjegimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës dhe konsultimeve me mbrojtësit e tyre, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e propozuara nga prokurori i shtetit dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje që qartë ligjore apo gabim faktik, andaj

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve për veprat penale për të cilat janë ngarkuar me aktakuzë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre av. Urim Pozhegu dhe av. Feride Xani, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit siç janë deklarata e të padehurve M. I. t, R. K., F. K., V. P., raportet e oficerit H. S. dt. 14.07.2021, 15.07.2021 dhe 16.07.2021, si dhe raporti i oficerit Sh. S. datës 14.07.2021, lista e armëve të konfiskuara dt. 16.07.2021 si dhe foto dokumentacioni i shkresave të lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari V. P., me dashje ka kryer veprën penale importi, eksporti, prodhimi, këmbimi ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve apo mjeteve plasëse nga neni 364 par.1 të KPRK-së, si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi, i akuzuari F. K. me dashje ka kryer veprat penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-

së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, si në dispozitivin II dhe III të këtij aktgjykimi, i akuzuari R. K. dhe M. I. me dashje kanë kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, si në dispozitivin IV dhe V, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitivin I, II, III dhe IV dhe V të këtij Aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarve me rastin e matjes së dënimit, kryetari i trupi gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana lehtësuese dhe disa rrethana posaçërisht lehtësuese dhe rrethana rënduese. Për të akuzuarin V. P. dhe F. K., prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: i akuzuari V. P., është mbajtës i vetëm i familjes, atë i një fëmijë, më herët nuk ka qenë i gjykuar, ndërsa për të akuzuarin F. K., është i moshës së re, sjelljen korrekte në shqyrtim gjyqësor, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marr për bazë pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, e duke i marr për bazë të lartpërmendurat gjykata ka zbatuar dispozitën e zbutjes së dënimit nga neni 71 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së, dhe në rastin konkret ka aplikuar dispozitat nga neni 72 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-së, ku i ka shqiptuar dënimet me burgim nën kufijtë e përcaktuar me ligj. Ndërsa për të akuzuarin R. K. dhe M. I., si rrethana lehtësuese ka marr për bazë sjelljen korrekte të tyre gjatë shqyrtimit fillestarë, moshën e tyre të re, kanë shprehur keqardhje, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata ka marr për bazë pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, ndërsa rrethana rënduese për të akuzuarit gjykata nuk ka gjetur. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarit, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv I, II, III, IV dhe V të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjnë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi konfiskimin e armës

Duke u bazuar në nenin 366 paragrafi 3 të KPRK, kryetari i trupit gjykues ka vendosur aktgjykimi si objekte të që ndaj të akuzuarit të konfiskohen pjesët e armëve dhe municionit si në dispozitiv të këtij veprës penal.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 të KPP-së si dhe konform nenit 39 paragrafi.3 nënparagrafi.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, kryetari trupi gjykues ka vendosur që i akuzuari t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti për Krime të Rënda -
PKR.nr.102/2021, të datës 26.10.2021

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Kryetari i trupit gjykues,
Shaqir Zika

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.